

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pas salmonelës Mondit i diMal sjell 41 kg kokainë nga Brazili
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1391664.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 21:14:02 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	14 shtator 2026, 21:05:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 14 shtator 2026, 21:04:00 UTC → 14 shtator 2026, 21:06:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4a0d4f5334372df1f2e805011b24675a1150a8b73cdceb9674d3937a15909dfd
TEKSTI	c20beae37060b90a70095b8c55e5c21f24025822f1212356f6e000099b8d7b0a
PAMJA	3b469466f2426562865e0acd031b177fb42f008619684c8eb7d24cb63762f39c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	16690500e1a40bea92c8cf48d9b8102b952f55065e839e1fd83644ea8a78a954
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	14f4bd53e2e66d8385ba6de2378a49e0445f54add9285267e471b01ae86271f6
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/16690500e1a40bea92c8cf48d9b8102b952f55065e839e1fd83644ea8a78a954>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Pas salmonelës Mondit i diMal sjell 41 kg kokainë nga Brazili

Shkruar nga: B Shehu | Publikuar më: 14.09.2026, 23:05

 Share
  Share



Kur bëhet fjalë për magazinat e AMG Food, duket se importi i mishit të pulës nga Brazili nuk është thjesht një biznes ushqimor, por një linjë shpërndarjeje me shumë opsione. Nëse në mars të vitit 2025 kompania e drejtuar nga Mondit Goxha na serviri specialitetin e shtëpisë me salmonelë, ku nga 18.3 tonë fileto pule që zbritën në Portin e Durrësit, 13.1 tonë u shpërndanë me shpejtësi të 154 klientë para se të bllokoheshin vetëm 5.2 tonë e mbetur, shfaqja e këtij viti e ka çuar efikasitetin e tyre në një nivel tjetër.

Pak më shumë se dymbëdhjetë muaj më vonë, e njëjta kompani, e njëjta linjë furnizimi nga Brazili (për të cilën importi është ndaluar që prej 3 shtatorit, duke e bërë dokumentacionin edhe më "interesant") dhe i njëjti Port i Durrësit na sjellin një befasi akoma më të madhe: 41.35 kilogramë kokainë të pastër, me vlerë rreth 2 milionë euro, të ndarë në 37 pako të fshehura fiks te kapakët e jashtëm të kontejnerit. Është vërtet për t'u habitur se si magazinat e tyre tërheqin gjithmonë ngarkesa kaq "shpërthyes", duke kaluar pa u munduar nga bakteret të lënda narkotike e pastër.


Përballë kësaj historie të përsëritur, ku për salmonelën vëllezërit Arben dhe Mondit Goxha u proceduan në gjendje të lirë dhe çështja shkoi në Prokurori, është e qartë se biznesi i tyre nuk nje pengesa burokratike. Në fund të fundit, çfarë rëndësie kanë rregullat e kontrollit sanitar apo ndalimi i importit, kur kontejnerët e tyre vijnë të pajisur një herë me mikrobe të pista dhe një herë me mallra kaq të shtrenjta e të paligjshme?

Nga salmonela e 2025-ës te pluhuri i bardhë i 2026-ës, AMG Food po dëshmon se çdo ngarkesë në Durrës është një lotari ku surprizat fshihen te kapakët e kontejnerit. Kjo mrekulli nuk do të bëhej pa burokracinë dhe aferat klienteliste të AKU-së, që, në vend të kontrollit, u hapi dyert me leje speciale, duke provuar se për vëllezërit Goxha shteti është thjesht një bashkëudhëtar i sigurt nga Brazili te pjatat dhe xhepat tanë.

FACT CHECK: Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e [raportoni këtu](#).

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME



Më të Lexuarat



ARTIKULL JOETIK?

Më të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

[Puno me ne!](#)

[Marketing](#)

[Politika e privatësisë](#)

[Rreth Nesh](#)

[Kushtet e përdorimit](#)

[Kontakt](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.